

Në
këtë
periodik
do të lexoni:

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive
prezanton
Raportin Vjetor të AMF-së
për vitin 2024



VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri,
Janar-Shtator 2025

6 - 7

INFORMACIONE NDËRKOMBËTARE

8 - 11

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive prezanton Raportin Vjetor të AMF-së për vitin 2024



Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, znj. Mimoza Kaçi, prezantoi sot në Komisionin Parlamentar të Ekonomisë, Financave dhe Punësimit dhe në Komisionin për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale Raportin Vjetor të veprimtarisë së Autoritetit për vitin 2024, një periudhë me zhvillime pozitive dhe dinamika në fushën e tregjeve financiare jobankare.

Në fjalën e saj, znj. Kaçi theksoi se Autoriteti ka vijuar punën në drejtim të forcimit të mbikëqyrjes së tregjeve, përmirësimit të kuadrit ligjor dhe rregullator të përafuar me standardet evropiane, mbrojtjen e interesave të investitorëve dhe konsumatorëve, duke kontribuar në stabilitetin financiar.

Prioritet kyç i punës së Autoritetit është procesi i integritimit evropian dhe përbushja e angazhimeve në kuadër të Kapitullit 9 “Shërbimet financiare”, i cili kryesohet nga Autoriteti. Në këtë kuadër janë ndërmarrë ndryshime të rëndësishme për harmonizimin e kuadrit ligjor dhe rregullator me direktivat dhe rregulloret e Bashkimit Evropian të fushës. Në prill të vitit 2025, u hapën negociatat me Bashkimin Evropian për grupkapitullin e dytë, pjesë e të cilit është edhe Kapitulli 9 “Shërbimet Financiare”.

Gjatë vitit 2024, tregjet financiare jobankare u paraqiten të mirëkapitalizuara dhe me tregues të qëndrueshëm të shëndetit financiar, duke vijuar një trajektore pozitive zhvillimi. Në fund të vitit, totali i aseteve të tregjeve nën mbikëqyrje arriti në 131 miliardë lekë, me një rritje prej 17% krahasuar me një vit më parë.

Në fjalën e saj, znj. Kaçi theksoi se Autoriteti ka vijuar punën në drejtim të forcimit të mbikëqyrjes së tregjeve, përmirësimit të kuadrit ligjor dhe rregullator të përafuar me standardet evropiane, mbrojtjen e interesave të investitorëve dhe konsumatorëve, duke kontribuar në stabilitetin financiar.

Vijon ...

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive prezanton Raportin Vjetor të AMF-së për vitin 2024



... Vijon

Tregu i sipërmarrjeve të investimeve kolektive gjatë vitit 2024 ka patur përmirësim të treguesve, si në nivel aktivesh me një rritje 22%, ashtu edhe në nivelin e flukseve neto pozitive, kthimit nga investimi dhe numri i investitorëve arriti në 37,786, me rritje prej 17,4%. Gjatë vitit, nisën aktivitetin dy fonde të reja investimi dhe u regjistruan fonde të reja me karakteristika ESG, në përputhje me praktikat e Bashkimit European.

Në vitin 2024, u licencua një shoqëri e re në tregun e sigurimit të jetës, duke e zgjeruar në 13 numrin e kompanive që operojnë në tregun e sigurimeve. Në këtë treg vijoi prirja pozitive, me përmirësim të mëtejshëm të treguesve kryesorë financiarë. Aktivitetet e tregut u rritën me rreth 6 miliardë lekë ose 12%, provigjonet teknike me rreth 2.49 miliardë lekë ose 9.8%, primet e shkruara bruto u rritën me 7%, duke arritur në 25 miliardë lekë, ndërsa dëmet e paguara bruto u rritën me 24.3%, në një total prej 9 miliardë lekësh. Raporti dëme/prime arriti në 41%, për herë të parë brenda diapazonit të rekomanduar për industrinë. Fondi i Kompensimit shënoi një ulje prej 18% të dëmeve pezull, duke arritur nivelin më të ulët historik.

Autoriteti, në zbatim të rekomandimeve të CEFTA-s dhe në bashkëpunim me Byronë Shqiptare të Sigurimit, mundësoi lehtësimin e lëvizjes ndërkufitare të automjeteve me targa shqiptare drejt Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi, duke ulur kostot për drejtuesit e mjeteve, gjë që nxiti shkëmbimet ekonomike me vendet fqinje.

Vijon ...

Në vitin 2024, u licencua një shoqëri e re në tregun e sigurimit të jetës, duke e zgjeruar në 13 numrin e kompanive që operojnë në tregun e sigurimeve.

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive prezanton Raportin Vjetor të AMF-së për vitin 2024

... Vijon

Gjatë vitit 2024, tregu i pensioneve private vijoi rritjen, aktivet rezultuan 8.11 miliardë lekë ose 20.3% më shumë se një vit më parë dhe numri i anëtarëve arriti në 44,263. Autoriteti përfundoi hartimin dhe miratimin e kuadrit të plotë rregullator në zbatim të ligjit “Për fondet e pensionit privat”.

Tregjet e kapitalit shënuan rritje, ku shuma e obligacioneve të emetuara me ofertë private arriti në 28 miliardë lekë, me një rritje prej 40%, dhe vëllimi i instrumentave financiarë të bankave në tregjet e huaja arriti në 80 milionë euro gjatë vitit 2024. Autoriteti avancoi në zbatimin e Dokumentit të Politikave për Zhvillimin e Tregjeve të Kapitalit 2023–2027.

Autoriteti është i angazhuar për një organizim të jashtëzakonshëm të Konferencës Vjetore të Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), që do të zhvillohet në Tiranë në nëntor 2025 dhe do të mbledhë mbi 500 pjesëmarrës - përfaqësues të autoriteteve mbikëqyrëse, institucioneve financiare dhe industrisë së sigurimeve nga mbi 150 vende. Ky aktivitet që organizohet për herë të parë në Shqipëri dhe në rajon, është ngjarja më e rëndësishme globale në fushën e sigurimeve, duke reflektuar vlerësim për Autoritetin dhe bashkëpunimin e ngushtë me institucionet homologe dhe ato ndërkombëtare.

Autoriteti është i angazhuar për një organizim të jashtëzakonshëm të Konferencës Vjetore të Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), që do të zhvillohet në Tiranë në nëntor 2025 dhe do të mbledhë mbi 500 pjesëmarrës - përfaqësues të autoriteteve mbikëqyrëse, institucioneve financiare dhe industrisë së sigurimeve nga mbi 150 vende.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, janar – shtator 2025

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për janar – shtator 2025 kapën vlerën 20,183 milionë lekë, ose 10.37% më shumë se në janar – shtator 2024. Gjatë periudhës janar – shtator 2025, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 1,249,988 me një rritje prej 6.16% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.


Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 91.69% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 8.27% dhe risigurimi me 0.033%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 38.19% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 61.81% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar – shtator 2025, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 6,182 milionë lekë, ose 0.02% më pak se në janar – shtator 2024.

Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për janar – shtator 2025 kapën vlerën 4,700 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 3.33% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik, gjatë periudhës janar – shtator 2025 arritën rreth 12,474 milionë lekë, ose 12.96% më shumë se në janar – shtator 2024.

Struktura e tregut të sigurimeve, janar-shtator 2025 (Në %)



Zhvillimet e Tregut të Titujve të Qeverisë jashtë Bursës për periudhën janar - shtator 2025

Të dhënat statistikore të tregut të titujve të Qeverisë jashtë Bursës për periudhën janar - shtator 2025, flasin për një dominim të transaksioneve “Marrje dhe Transmetim urdhri në tregun primar (Ankand)” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” përkatësisht me 54.03% dhe 40.09% kundrejt vëllimit të përgjithshëm.

Vëllimi i tregut sekondar të titujve të Qeverisë të realizuara jashtë Burse për periudhën janar - shtator 2025, u dominua në masën 54.33% nga transaksione në instrumente afatgjatë (obligacione) dhe 45.67% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari). Parë nga këndvështrimi i numrit të transaksioneve, 72.51% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të titujve të Qeverisë jashtë Burse, i takojnë transaksioneve të kryera në bono thesari.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të titujve të Qeverisë jashtë Burse, për periudhën janar - shtator 2025 dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 98.13% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

Tre grupet e transaksioneve B, C dhe F

Transaksioni i llojit B “Tregtim për llogari të vet kur ekzekuton urdhrat e klientit (Shitja e titujve të Qeverisë investitorit nga portofoli i bankës, apo shoqërisë komisionere)” gjatë periudhës janar - shtator 2025, ka pasur një ulje prej 4,938 milionë lekë ose 67.56% krahasuar me periudhën janar - shtator 2024. Gjithashtu edhe numri i transaksioneve i llojit B është ulur në masën 52.91%.

Transaksioni i llojit C “Tregtim për llogari të vet kur ekzekuton urdhrat e klientit (Blerja e titujve të Qeverisë nga banka apo shoqëria komisionere para datës së maturimit nga investitori)” gjatë periudhës janar - shtator 2025, ka pasur një rritje prej 40.71 milionë lekë ose 1.99% dhe me një ulje prej 4.81% në numrin e transaksioneve, krahasuar me periudhën janar - shtator 2024.

Gjatë periudhës janar-shtator 2025 nuk janë ekzekutuar transaksione, të llojit F “Ekzekutimi i urdhrat të klientit (jo nga dhe për llogari të portofolit të subjektit)”.

Në totalin e transaksioneve të llojit B, C dhe F të marra së bashku, vihet re një ulje në vlerë absolute me rreth 5,103 milionë lekë, krahasuar me periudhën janar - shtator 2024.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të titujve të Qeverisë jashtë Burse, për periudhën janar - shtator 2025 dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 98.13% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

GREQI

www.xprimm.com

Sipas shifrave për gjashtëmujorin e parë 2025, të publikuara nga HAIC - Shoqata Helenike e Kompanive të Sigurimeve, tregu i sigurimeve në vend arriti në 2.9 miliardë euro, duke shënuar një rritje prej 3% në krahasim me 2.82 miliardë euro që ishte kjo shifër në gjashtëmujorin e parë 2024. Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 9.7% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke arritur vlerën e 1.58 miliardë euro. Sigurimi i Jetës gjeneroi rreth 1.32 miliardë euro vlerë e primeve të shkruara bruto, duke shënuar një rënie prej 3.9% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i pronës pati një rritje të përgjithshme prej 10.6%, duke arritur në 332.8 milionë euro. Në vitin 2025, siguruesit iu përgjigjën frekuencës së shtuar të ndodhive natyrore. Fenomenet ekstreme të motit (reshjet - përmytjet) kanë ndikuar në Greqi gjatë periudhës 29 mars - 2 prill 2025. Sipas të dhënave të ofruara nga kompanitë e sigurimeve që morën pjesë në një anketë përkatëse të HAIC, u raportuan gjithsej 476 humbje. Shuma e dëmit të paguar vlerësohet në një total prej 7.2 milionë eurosh. Nga këto, 341 humbje kishin të bënin me sigurimin e pronës (dëmet e vlerësuara prej 6.9 milionë eurosh), 134 humbje kishin të bënin me sigurimin e makinës (vlerësohen 232 mijë euro) dhe 1 humbje kishte të bënte me sigurimin e anijes (vlerësohen 40 mijë euro).

Sipas të dhënave më të fundit të HAIC, numri i shtëpive të siguruara si kundër fenomeneve të motit ashtu edhe kundër tërmeteve është rritur vazhdimisht, duke arritur në 662,452 polica sigurimi deri në mars 2025, nga rreth 509,000 në shtator 2023. Struktura në mbulimin me sigurim të shtëpive, sipas llojit të rrezikut në fund të tremujorit të parë 2025 paraqitet:

- Fenomene moti: 124,789 kontrata (12.3%)
- Tërmet: 189,532 kontrata (18.6%)
- Si moti ashtu edhe tërmeti: 660,160 kontrata (65%)
- Vetëm zjarri (duke përjashtuar motin/tërmetin): 41,734 kontrata (4.1%)

KOSOVA

www.xprimm.com

Sipas të dhënave zyrtare të ofruara nga Banka Qendrore e Kosovës, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2025, siguruesit në vend kanë realizuar prime të shkruara bruto me vlerë 87.44 milionë euro, ose 6.6% më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Dëmet e paguara arritën rreth 42.35 milionë euro, duke u rritur me 21% krahasuar me të njëjtin periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i Jetës vazhdoi të ketë një prani të vogël në portofolin e tregut, duke mbajtur një pjesë prej 4.7% në vëllimin total të primeve të shkruara. Biznesi i sigurimit të Jo-Jetës përbën mbi 95% të volumit të primeve të shkruara bruto të tregut, duke mbajtur pjesën më të madhe të biznesit të siguruesve në vend. Nga vëllimi total i primeve të shkruara të sigurimeve të Jo-Jetës, më shumë se gjysma vjen nga linja e sigurimit MTPL (53%).

Vëllimi total i primeve të shkruara bruto të Jo-Jetës arriti vlerën prej 83.3 milionë euro, që tregon një rritje prej 6.6% krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2024. Numri i policave të sigurimit të Jo-Jetës arriti në 795,452, që është 15.24% më pak në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Vëllimi total i primeve të sigurimeve të Jetës arriti në 4.14 milionë euro, duke u rritur me 6.3% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Numri i policave të sigurimit të Jetës arriti në 47,641, duke u rritur me 21.5% në krahasim me gjashtëmujorin e parë 2024.

QIPRO

www.xprimm.com

Sipas të dhënave nga Shoqata e Sigurimeve të Qipros – IAC, industria e sigurimeve në vend vazhdoi trendin e saj rritës edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2025, duke siguruar një total prej 696 milionë euro ose me rritje rreth 10.16% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Ky trend u demonstrua si nga sektori i sigurimeve të Jo-Jetës, ashtu edhe nga ai i sigurimit të Jetës.

Sigurimi i Jetës, duke përjashtuar primet e aksidenteve dhe shëndetit, arriti në 363.94 milionë euro, duke shënuar një rritje prej 12.7% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Të ardhurat nga sigurimi i Jetës arritën në 323.46 milionë euro, ndërsa planet e pensioneve në grup mblodhën 40.48 milionë euro. Në të njëjtën kohë, sigurimet e Jo-Jetës patën një rritje prej 7.5% duke arritur në 332.06 milionë euro.

Primet e Aksidenteve dhe Shëndetit nga të gjitha kompanitë arritën në 75.7 milionë euro në gjysmën e parë të vitit 2025, krahasuar me 71.32 milionë euro në vitin 2024.

Sigurimi nga zjarri, pati një trend të përsheptuar, me primet që u rritën në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar me 8.3%, duke arritur në 76.9 milionë euro. Sigurimi i përgjegjësisë regjistroi një rritje prej 4.8%, duke arritur në vlerën e primeve prej 40.9 milionë euro.

MALI I ZI

www.xprimm.com

Sipas shifrave paraprake të publikuara nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Malit të Zi (ISA), biznesi i siguruesve në vend, gjatë gjashtëmujorit të parë 2025, u rrit me 11% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2024, duke arritur në 75.78 milionë euro. Sigurimi i Jetës vazhdon të ketë më pak se 20% në portofolin e tregut, duke arritur një vëllim të primeve të shkruara bruto me vlerë 13.94 milionë euro. Sigurimi i Jo-Jetës, mbeti pothuajse i pandryshuar, me ndryshime të vogla vetëm të peshës së linjave të ndryshme të biznesin në vlerën totale. Sigurimi i detyrueshëm MTPL mbeti linja më e madhe e biznesit, dhe përbën 33.5% të totalit të primeve të shkruara bruto. Shuma totale e dëmeve të paguara ishte 28.8 milionë euro, një rritje prej 6.1% krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2024.

SLLOVAKI

www.xprimm.com

Sipas statistikave zyrtare të Bankës Kombëtare Sllovaqe, vëllimi total i primeve të shkruara bruto për siguruesit sllovakë arriti në 1.14 miliardë euro në gjysmën e parë të vitit 2025. Kjo shifër është 7.98% më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Po sipas këtyre statistikave, dëmet e paguara nga siguruesit sllovakë arritën në 589.5 milionë euro, ose 3.96% më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Ndryshimi vjetor në përqindje, megjithëse vlerat absolute janë mjaft modeste, është ai që ka të bëjë me dëmet e paguara për sigurimin motorik me një rritje prej 13.8% në nivel vjetor, në veçanti për sigurimin e detyrueshëm MTPL i cili u rrit me 25.3% më shumë në terma vjetore.

TURQI

www.xprimm.com

Sipas Shoqatës së Sigurimeve të Turqisë (TSB) tregu i sigurimeve në vend vazhdoi të zgjerohej me shpejtësi në gjysmën e parë të vitit 2025. Vëllimi total i primeve të shkruara bruto u rrit me 51.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke arritur në 576.75 miliardë TRY. E shprehur në euro vlera e primeve arrin rreth 12.35 miliardë euro, me rritje +14.3%. Zhvlerësimi i ndjeshëm prej 30% i lirës turke kundrejt euros ndryshoi ndjeshëm shifrat e rritjes kur shprehen në monedhë të huaj, duke theksuar ndikimin e vazhdueshëm të paqëndrueshmërisë së kursit të këmbimit në performancën e tregut.

Sektori i sigurimeve të Jetës shënoi një rritje prej 81% të vëllimit të primeve, duke arritur në 78.52 miliardë TRY (1.68 miliardë euro, +36.5%). Ndërsa sigurimet e Jo-Jetës u rritën me 47.8% duke arritur në 498.23 miliardë TRY (10.67 miliardë euro, +11.4%). Sigurimet shëndetësore panë zgjerimin më dinamik me rritje +70.5% e shprehur në monedhën vendase.

Sigurimi motorik ruajti pozicionin e tij kryesor, duke përfaqësuar 36.3% të totalit të primeve. Nga kjo rritje, dy të tretat erdhën nga sigurimi MTPL i detyrueshëm, që regjistroi 143.93 miliardë TRY (3.08 miliardë euro) në prime.

Pavarësisht rritjes së fortë të primeve, përfitueshmëria e segmentit vazhdoi të përkeqësohej për shkak të inflacionit të vazhdueshëm dhe zhvlerësimit të monedhës. Sektori MTPL regjistroi humbje rekord prej 23.9 miliardë TRY (579 milionë dollarë amerikanë) në gjysmën e parë të vitit 2025, më shumë se dyfishi i humbjes prej 10.1 miliardë TRY të raportuar një vit më parë. Të gjitha kompanitë aktive në MTPL raportuan rezultate negative, duke nënvizuar çekuilibrin strukturor midis mjaftueshmërisë së primeve dhe kostove të kërkesave.

Megjithatë, pavarësisht sfidave të vazhdueshme të realizimit të fitimit në segmentin MTPL, siguresit turq e mbyllën gjysmën e parë të vitit 2025 me një rezultat të përgjithshëm financiar të fortë, duke shënuar një fitim bruto prej 560 milionë eurosh (26.15 miliardë lira turke). Segmenti i sigurimit të Jetës kontribuoi me një rezultat teknik prej 309 milionë eurosh (14.43 miliardë lira turke), ndërsa segmenti i sigurimit të Jo-Jetës dha një performancë dukshëm më të fortë, duke arritur një rezultat teknik prej 1.43 miliardë eurosh (66.75 miliardë lira turke).



Për informacion
të mëtejshëm
kontakttoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al